

## UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

**September 20 - 21** - DMEXCO Köln

**September 26** - East-West BAYERN Forum

**October 7 - 11** - ANUGA Köln

**October 11 - 12** - 9th BME Purchasing Initiative Western Balkans

## DIRECTOR'S NOTE

### Të nderuar anëtarë,

Javën që po lëjmë pas angazhimi i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare dhe ekipit të saj ka qenë në disa drejtime. Po ndajmë me ju një përmbledhje të ngjarjeve të rëndësishme që lidhen me zhvillimet ekonomike që afektojnë në punët e bizneseve:

### Dear members,

During the past week, the German-Kosovar Business Association and its team have been engaged in various directions. We would like to share with you a summary of important events related to economic developments that impact businesses:

### **Përfundon sesioni pranveror i Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Ekonomi dhe Ndërmarrësi pati këtë performancë**

Kosovo Democratic Institute ka nxjerr raportin e punës për Kuvendin e Kosovës gjatë sesionit pranveror, duke i përcjell edhe komisionet veç e veç.

Komisioni për Ekonomi dhe Ndërmarrësi gjatë këtij sesioni pranveror mbajti gjithsej 24 mbledhje dhe 3 dëgjime publike. Për rreth shtatë muaj sa zgjati sesioni, komisioni në fjalë shqyrtoi gjithsej 6 projektligje për tema si energjia, investimet e qëndrueshme, minierat dhe mineralet, mbrojtja e konsumatorit etj. Po ashtu u shqyrtuan edhe 14 raporte të institucioneve dhe agjencive si dhe dy vendime të Qeverisë.

Para komisionit raportuan ministra e zyrtarë të lartë institucional. Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli raportoi 5 herë para këtij komisioni qoftë për të paraqitur projektligje apo për të prezantuar raportet e performancës së kësaj

### **The spring session of the Assembly of Kosovo concludes, the Committee for Economy and Entrepreneurship had this performance**

The Kosovo Democratic Institute has released a report on the work of the Assembly of Kosovo during the spring session, also tracking the individual committees.

During this spring session, the Committee for Economy and Entrepreneurship held a total of 24 meetings and 3 public hearings. Over the course of about seven months, this committee reviewed a total of 6 draft laws covering topics such as energy, sustainable investments, mining and minerals, consumer protection, and more. Additionally, 14 reports from institutions and agencies, as well as two decisions from the Government, were also reviewed.

Ministers and senior institutional officials reported to the committee. The Minister of Economy, Artane Rizvanolli, reported before this committee 5 times, either to present draft laws or to present performance reports of the

ministrie. Ngjashëm, Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë Rozeta Hajdari ishte dy herë para komisionit, ndërsa mungoi në një rast kur ishte e ftuar nga ky komision.

Në anën tjetër, 14 herë raportuan për punën e tyre përfaqësues të bordeve të kompanive si Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) etj.

Diskutimet kryesore në këtë komision u zhvilluan rreth çështjes së energjisë dhe ndërmarrjes Ferronikeli. Për këtë të fundit komisioni rekomandoi shkarkimin e anëtarëve të Bordit të KPMM-së, në mënyrë individuale, si dhe anulimin e vendimit mbi lirimin e obligimit të rentës minerare të ndërmarrjes "Ferronikeli"

Gjatë kësaj periudhe ky komision miratoi edhe raportin për mbikëqyrjen e Ligjit për komunikime elektronike.

ministry. Similarly, the Minister of Industry, Entrepreneurship, and Trade, Rozeta Hajdari, appeared before the committee twice, while being absent on one occasion when invited by this committee.

On the other hand, representatives of company boards reported 14 times about their work, including the Independent Commission for Mines and Minerals (KPMM), the Energy Regulatory Office (ZRRE), the Kosovo Privatization Agency (AKP), the Regulatory Authority for Electronic and Postal Communications (ARKEP), the Regulatory Authority for Water Services (ARRU), and more.

The main discussions in this committee revolved around energy issues and the Ferronikeli enterprise. Regarding the latter, the committee recommended the removal of members of the KPMM Board on an individual basis, as well as the annulment of the decision to waive the mining royalty obligation of the "Ferronikeli" enterprise.

During this period, the committee also approved the report on the oversight of the Law on Electronic Communications.

## **OEGJK mori pjesë në lansimin i "Open Data" të ATK-së**

Administrata Tatimore e Kosovës, me përkrahjen e USAID-it, ka lansuar bazën e të dhënave të hapura në një tryezë të organizuar me akterët e angazhuar në këtë drejtim. Aty mori pjesë edhe Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, e përfaqësuar nga Sytrime Dervisholli dhe Besarta Hyseni.

Tashmë në Administratën Tatimore të Kosovës do të ketë një hapësirë e cila do të ketë të dhëna të hapura për disa kategori: Gjoha nga Raportimet, Arka Fiskale, Qarkullimi, Të Hyrat, Deklarimi, Numri i punëtorëve, Numri i punëtorëve ID, Pagesa sipas Periudhës, Rimbursimet dhe Regjistri Aktiv.

Ky është konsideruar një hap shumë i madh për transparencën e ATK-së, por gjithashtu një lehtësi e madhe për qasje në të dhëna të cilat shërbejnë për analizë dhe pasqyrim të gjendjes reale ekonomike në vend.

## **KDWV participated in the launch of "Open Data" by the Tax Administration of Kosovo (TAK)**

The Kosovo Tax Administration, with the support of USAID, has launched an open data platform during a gathering involving stakeholders engaged in this direction. The German-Kosovar Business Association, represented by Sytrime Dervisholli and Besarta Hyseni, also took part in the event.

Now, the Kosovo Tax Administration will have a space containing open data in various categories, including Penalties from Reports, Fiscal Register, Circulation, Revenues, Declarations, Number of Employees, Employee ID Numbers, Periodic Payments, Reimbursements, and Activity Register.

This is considered a significant step towards transparency for the Kosovo Tax Administration, providing easy access to data that serves for analysis and reflects the actual economic situation in the country.



## **Ministria e Drejtësisë nxjerr Rregulloren për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit dhe detajeve tjera për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt**

Ministria e Drejtësisë në Kosovë ka nxjerrë Rregulloren për procedurën e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Kosovë.

Kjo Rregullore ka për qëllim të rregullojë procedurat e përcaktimit dhe verifikimit të reciprocitetit, organin e autorizuar për përcaktimin e reciprocitetit, kushtet, përmbajtjen dhe mënyrën e mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për ekzistimin e reciprocitetit me vende të veçanta për fitimin e të drejtave pronësore mbi pronën e paluajtshme nga të huajt në Republikën e Kosovës.

Rregulloren mund ta lexoni [në këtë link](#), bashkangjitur brenda të cilës janë edhe formularët.

- ✓ Nënshkruhet **rregullorja** për Procedurën e Përcaktimit dhe Verifikimit të Reciprocitetit, Përmbajtjen dhe Mënyrën e Mirëmbajtjes së Bazës së të Dhënave për **Fitimin e të Drejtës së Pronësisë** mbi **Pronën e Paluajtshme nga të Huajt në Kosovë**



## **The Ministry of Justice issues Regulation on the procedure of determination and verification of reciprocity and other details for acquiring the right to ownership over immovable property by foreigners.**

The Ministry of Justice in Kosovo has issued a Regulation on the procedure of determination and verification of reciprocity, conditions, content, and maintenance of the database for acquiring the right to ownership over immovable property by foreigners in Kosovo.

This Regulation aims to regulate the procedures of determining and verifying reciprocity, the authorized body for determining reciprocity, conditions, content, and maintenance of the database for the existence of reciprocity with specific countries for acquiring property rights over immovable property by foreigners in the Republic of Kosovo.

You can read the Regulation [at this link](#), within which the forms are also attached:

- ✓ **Bashkëkombësit** tanë të cilët duan të fitojnë të drejtën e pronësisë mbi pronat e paluajtshme, por edhe **investitorët e huaj e subjektet tjera**, do të mund ta realizojnë këtë të drejtë pranë autoritetit kompetent sipas rregullave të përcaktuara me këtë rregullore.



## **Rezultatet e Anketës "Balkan Barometer 2023", të komisionuar nga Këshilli Rajonal për Bashkëpunim (RCC)**

Balkan Barometri është anketa vjetore e komisionuar nga Këshilli Rajonal për Bashkëpunim, që realizon matjen e opinionit publik dhe opinionit të bizneseve në gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor.

Sipas Balkan Barometer 2023, që përgatitet nga Këshilli Rajonal për Bashkëpunim (RCC):

44% e të anketuarve në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor mendojnë të largohen nga vendet e tyre, që shënon rritje prej 5% krahasuar me vitin 2022, ndërsa Kosova zë vendin e parë me gjithsej 57%, pasuar nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut.

74% e bizneseve të anketuara e konsiderojnë bashkëpunimin rajonal të rëndësishëm për biznesin e tyre, ndërsa 83% e bizneseve kosovare mendojnë kështu, paraprirë nga Shqipëria dhe Bosnja dhe Hercegovina.

70% e bizneseve të rajonit nuk i shohin ndryshimet klimatike si problem. Gjysma e bizneseve të rajonit kanë përfituar nga marrëveshja e Roaming pa pagesë. Kosova prinë këtu nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, me 94%.

Për më shumë informacione: [Balkan Barometer | Welcome \(rcc.int\)](http://Balkan_Barometer_Welcome(rcc.int))

## **Results of the "Balkan Barometer 2023" Survey, commissioned by the Regional Cooperation Council (RCC)**

The Balkan Barometer is an annual survey commissioned by the Regional Cooperation Council, which measures public opinion and business sentiment in the six economies of the Western Balkans.

According to the Balkan Barometer 2023, prepared by the Regional Cooperation Council (RCC):

44% of respondents in the 6 countries of the Western Balkans consider leaving their countries, marking a 5% increase compared to 2022. Kosovo ranks first with a total of 57%, followed by Albania, Montenegro, Serbia, Bosnia and Herzegovina, and North Macedonia.

74% of surveyed businesses consider regional cooperation important for their business, with 83% of Kosovo businesses sharing this sentiment, followed by Albania and Bosnia and Herzegovina.

70% of businesses in the region do not see climate change as a problem. Half of the businesses in the region have benefited from the Free Roaming agreement. Kosovo leads in this regard among the 6 countries of the Western Balkans, with 94%.

For more information: [Balkan Barometer | Welcome \(rcc.int\)](http://Balkan_Barometer_Welcome(rcc.int))

## YOUR CONTACT PERSONS AT KDWV



Znj. Sytrime Dervisholli,  
Udhëheqëse e departamentit  
për marrëdhënie me qeverinë  
dhe avokim mund ta  
kontaktoni në:

[sytrime.dervisholli@oegjk.org](mailto:sytrime.dervisholli@oegjk.org)

Sytrime Dervisholli, Head of  
Department for Government  
Relations and Advocacy can  
be contacted at:

[sytrime.dervisholli@oegjk.org](mailto:sytrime.dervisholli@oegjk.org)

Ekipi i znj. Dervisholli nuk është vetëm përgjegjës për përfaqësimin e interesave të anëtarëve, por gjithashtu koordinon gjashtë grupet punuese të OEGJK-së, dhe punon në publikimet tona, si dhe në raportet sektoriale:  
[Publikimet e OEGJK-së](#)

The team of Ms. Dervisholli is not only responsible for representing the interests of KDWV-members, but also coordinates the six working groups of KDWV, and works on our publications, as well as on sector reports:  
[Publications](#)



Udhëheqëse e  
departamentit për  
mbështetjen dhe  
shërbimet e anëtarëve  
është znj. Besarta Hyseni:  
[besarta.hyseni@oegjk.org](mailto:besarta.hyseni@oegjk.org)

Head of Market Entry and  
Events is:

[besarta.hyseni@oegjk.org](mailto:besarta.hyseni@oegjk.org)

Ekipi i znj. Hyseni jo vetëm që mbështet anëtarët me eksport, këshilla ligjore (kemi këshilltarë ligjorë në ekip), këshilla për Joint Venture, Franchise dhe Senior Expert Service, por gjithashtu organizon takime B2B, udhëtime delegacioni, punëtori dhe ngjarje informuese për anëtarët.

The team of Ms. Hyseni not only supports members regarding export, legal advisory services (KDWV has in-house lawyers), Joint Venture, Franchise and Senior Expert Service, but also organizes B2B meetings, delegation trips, workshops, and info-sessions for members.



Për çështje financiare (pagesa  
e anëtarësimit/faturat etj.)  
mund ta kontaktoni znj. Greta  
Kazia:

[greta.kazia@oegjk.org](mailto:greta.kazia@oegjk.org)

For financial matters  
(membership fees/invoices,  
etc.) please contact Ms. Greta  
Kazia:

[greta.kazia@oegjk.org](mailto:greta.kazia@oegjk.org)



Për këshillim ligjor të  
investitorëve gjerman dhe  
anëtarëve të OEGJK mund  
ta kontaktoni znj. Gonxhe  
Abazi:

[gonxhe.abazi@oegjk.org](mailto:gonxhe.abazi@oegjk.org)

For legal advice to German  
Investors and members of  
KDWV please contact Ms.  
Gonxhe Abazi:

[gonxhe.abazi@oegjk.org](mailto:gonxhe.abazi@oegjk.org)

### BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWV-OEGJK:

ICON Tower, 9th Floor, Rr. Bekim Fehmiu 110; 10000 Prishtina  
Monday - Friday | 8.00 - 17.00